

PKR.nr.205/12

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE** – Departamenti për Krime të Rënda në Gjiilan, kolegji i përbërë nga gjyqtarët : Emine Salihu, kryetare, Aziz Shaqiri dhe Sadri Krasniqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Sermaxhaj, në lëndën penale të akuzuarit B. K., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK-ës, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK, të akuzuarit B. K., A. K.dhe M. M., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëveprim nga neni 153 par.2 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë publike të Qarkut në Gjiilan, PP.nr.102/11 të dt.22.07.2011, dhe shqyrtimeve të mbajtura gjyqësore, orale dhe publike, më dt.07.05.2015, 12.05, 10.06,2015, (ndërsa rishtas), më dt.20.04,03.05.2015, në prani të Prokurorit të shtetit Arben Kadriu, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, Elmi Qerimi, Enver Halili dhe Sabit Maliqi dt.06.05.2016, shpalli këtë

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. K.** pa pseudonim dhe emër të rrejshëm nga i ati R. dhe e ëma F., e lindur Z., i lindur më dt. ..., në fsh.D. ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme të mjeksisë "...", pjesërisht punon si kamarier në ... "..." në Gj., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

I akuzuari **A. K.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R. dhe e ëma R., e lindur H., i lindur më ..., në Gj., jeton në fsh.D., ka të kryer shkollën fillore, punon si ..., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

I akuzuari **M. M.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati N. dhe e ëma K. e lindur K., i lindur më dt. ..., në Gj., ka të kryer shkollën e mesme, jeton dhe punon në Z., në adresën ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

**ËSHTË FAJTORË****I.****I akuzuari B. K.**

Se më dt. ....2011, rreth orës ..., në rrugën regjionale të fsh.D., përballë ... "...", pas një mosmarëveshjeje paraprake të at 'qasshme, lidhur me një aksident trafiku, kanë dalur nga vetura e tyre L. dhe K. D. të cilën veturë e ngiste L., janë afruar 3-4 metra afër të akuzuarit B., i

*cili ishte në veturën e tij të markës "...", me mikun e tij E. K., të cilët pas aksidentit janë ndalur, e që L. i është drejtuar të akuzuarit B. me fjalët: "na e thyet pasqyrën e veturës, qysh po ja bëjmë, i akuzuari B. i është përgjigjur "po e thërrasim policinë", është larguar në distancë afro 2 metra larg tyre, e ka vuar telefonin afër veshit, kinse po e thërret policinë, e nxjerr revolen (nga ana e majtë e brezit) të markës "... të kal... mm, me nr. serik ..., mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, së pari shtënë një herë në drejtim të të dëmtuarit L. (por nuk ka mundur ta godas), deri sa i dëmtuari K. ishte në pozitë paralel në distancë afro 1 metër, në krahun e djathtë të dëmtuarit L., e më pas i akuzuari B. në distancë prej afro 3 m, shtënë dy herë në drejtim të të dëmtuarit K., duke e goditur me nga një predhë në të dy këmbët mbi gjunjë, me ç'rast i shkakton lëndime në regjionin femoral në të dy anët, lëndime të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit që si të tilla trajtohen me dëmtime të lehta trupore, dhe me pasoja të përkohëshme për shëndetin e të dëmtuarit, ashtu që ka rrezikuar edhe jetën e të dëmtuarit L. D., edhe pse nuk pësoi asnjë goditje, ndërsa i dëmtuari K. për ndihmë mjekësore dërgohet në Spitalin Regjional në Gjiilan.*

*Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK.*

*Andaj, trupi gjykues në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 73, 74,83 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,*

## **E G J Y K O N**

*Të akuzuarin B. K., për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit (lëndim i lehtë truporë nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK), me denim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftëse i akuzuari në kohën prej 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do t'ia revokon dënimin e shqiptuar, e në të cilin dënim ka për t'iu llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt. ..2011 e gjer më dt. ... .2011.*

*Në konform të nenit 363 par.1 pika 1.3, të KPPK-ës,*

## **REFUZOHET AKUZA**

### **II.**

*Për veprën penale nën pikën II të dispozitivit (mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armeve nga neni 328 par. 2 te KPK-së).*

*Se më datën, kohen dhe vendin si në dispozitivin 1 të kësaj aktakuze, në mënyr të pa autorizuar ka mbajtur në pronësi pa leje valide dhe ka përdorur revolen e markes "... kaliber ....mm, me nr serik. ... .*

*Meqë prokurori I shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale për shkak se kjo vepër penale është përfshirë në aktin e amnistisë.*

*Të akuzuarit B. K. I konfiskohet arma e zjarrtë edhe atë revole e markes “...” kaliber ....mm, me nr serik.... .*

*Në konform të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK-ës,*

*Ndaj të pandehurve B., A. K.dhe M. M.*

### **REFUZHET AKUZA**

#### **III.**

*Për veprën penale nën pikën III të dispozitivit (lëndim i lehtë trupor në bashkëveprim nga neni 153 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës).*

*Se në të njejtën ditë, pasi që i akuzuari B., kishte qëlluar të dëmtuarin K. dhe kishte shtënë në drejtim të të dëmtuarit L., e ndjek me revole në dorë të njejtin, dhe para kafiterisë “...”, në fsh. D., e kapë të njejtin dhe e godet me kondak të revoles, të dëmtuarit L. dhe V. dhe të akuzuarit A. dhe M., i godasin të dëmtuarit me grushta në pjesë të ndryshme të trupit të cilëve iu kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore.*

*Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.*

*I akuzuari B. K. obligohet që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €.*

### **Arsyetim**

*Prokuroria Publike e Qarkut, tani Prokuroria Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.102/11 të dt.22.07.2011, i ka akuzuar të akuzuarit B. K. për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 147 par.11 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-ës, të akuzuarit B. K., A. K.dhe M. Morina për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës.*

*1. Në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit bëri ricilësimin e veprës penale në pikën nën I. të dispozitivit , nga vepra penale vrasje në tentativë nga neni 147 par.11 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, në veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, duke shtuar se gjatë shqyrtimit të mbajtur gjyqësorë me administrimin e provave është vërtetuar se i akuzuari B. K. ka kryer veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, me propozim që gjykata të akuzuarin B. K.n për këtë vepër penale ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritor sipas ligjit.*

2. Për veprën penale në pikën II. të dispozitivit të aktakuzës (mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK) heqë dorë nga ndjekja penale meqë kjo veprë penale është përfshirë me ligjin e amnistisë, me propozim që të njëjtit ti konfiskohet revolva e markës “...” të kal.... mm, me nr. serik ... .

3. Mbeti në tërësi pranë kualifikimit të njëjtë të veprës penale si në dispozitivin nën 3 të aktakuzës ( lëndim i lehtë truporë në bashkëveprim nga neni 153 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës.

Trupi gjykues ka bërë rikualifikimin e veprës penale, nga vepra penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, në veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK-ës.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. K., av. E. Q., në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësorë, deklaroi se me shtjellimin e provave në shqyrtimin e mbajtur gjyqësorë nuk vërtetohet se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, por me provat e shtjelluara është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPK-ës, sepse i njëjti me veprimet e tij i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit K. D., njëherit edhe nga super ekspertiza e kryer nga Instituti i psikiatrisë forenzike në Prishtinë të dt.01.12.2015, është konstatuar se aftësia mendore e të akuzuarit, të kuptuarit dhe kontrollës së veprimeve të veta në momentin e kryerjes së veprës penale, ka qenë e zvogëluar, me propozim që të akuzuarit B. K. krahas dënimit të zvogëluar, gjykata ti shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

I dëmtuari **K. D.**, nga fsh.D., si gjatë fazës së hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë, deklaroi: ditën kritike kam qenë me djalin e agjës tim L. D., në veturë duke shkuar në drejtim të K. edhe atë në dalje të fsh.D. te shitorja e quajtur “...”. Veturën e markës “...” ka qenë duke e vozitur djali i agjës L.i, ora ka qenë ..., një veturë ishte duke ardhur prej anës së kundërt dhe e ka rrokë pasqyrën e veturës sonë në anën e majtë, ne vazhduam edhe nja 30 metra ma poshtë dhe jemi kthyer. Vetura tjetër e cila ka qenë me shpejtësi të madhe është kthyer te parku në rreth dhe jemi takuar te shitorja “...” të dy veturat. Ne dulëm prej veturës edhe atë unë dhe L.i, që të mirremi vesh për pasqyrën të cilët na e dëmtuan. Ne kemi dalur të parët nga vetura, menjëherë nga vetura tjetër kanë dalur B. K. me një person tjetër i cili nuk ka qenë nga Kosova, e që L.i është afruar nja 3-4 m afër B. dhe e pyeti na thyet pasqyrën, qysh po ia bëjmë B. tha po i thërrasim policinë dhe është kthyer mbrapa me shpinë nja 2 metra dhe e ka nxjerrë telefonin, dhe e vuri afër veshit kinse po e thërret policinë mirëpo me polici nuk ka folur, përsëri është kthyer me shpinë kah ne është larguar për nja 2 metra duke ecur dhe është kthyer kah ne, e ka nxjerrë revolen nga ana e majtë e brezit dhe ka shtënë në drejtim të L. edhe atë një herë, por L. nuk ka mundur ta qëllojë, i cili ka shtënë direkt në drejtim të L., në këtë moment unë kam qenë largë L. 1 metër dhe atë në drejtim paralel, në anën e djathtë të L. dhe menjëherë ka shtënë në drejtimin tim edhe atë dy herë dhe më ka goditur në të dy këmbët mbi gjunjë. Gjithsejtë kanë qenë 3 të shtëna për një herë. Unë menjëherë nga të

shtënat kam rënë në tokë kurse B. ka vazhduar në drejtim të parkut dhe atë duke e ndjekur L., po ceku edhe këtë se pasi shtëni B. një herë në drejtim të L., L. ka ikur duke vrapuar, edhe B. ka vrapuar pas tij. B. kur ka shtënë në drejtimin tim distanca ka qenë 3-4 metra, e njehta distancë ka qenë edhe me L. kur ka shtënë B. . Në momentin kur është shtënë me revole ne kemi qenë në gjendje të qetë do me thënë nuk kemi lëvizur as unë e as L. . Personi i cili e ka shoqëruar B. ka qenë afër tij 1-1.5 metër, edhe atë në pozitë paralele me B. . Personi i cili ka qenë me B. nuk ka ndërmarrë kurfarë veprimi që ta ndalë të njejtin e as që i ka ndihmuar B. në ndërmarrjen e ndonjë veprimi. Qëllimi i B. ka qenë që të më privojë mua nga jeta.

Prokurori i shtetit e ballafaqon të dëmtuarin – dëshmitari me deklaratën e dhënë në prokurori ku citon: në pyetjen se çka mendoni cili ka qenë qëllimi i B. ju jeni përgjigjur se “unë mendoj se po të kishte dashur B. të më vras ai ka mundur të më qëlloj në pjesë vitale të organizmit, mirëpo prap qëllimi i tij ka qenë që të më privojë nga jeta”. Unë mendoj se qëllimi i tij ka qenë që të më privojë nga jeta por fati ka dashtë që unë kam shpëtuar. Pasi që unë kam ra në tokë pas të shtënave, B. është ofruar dhe më ka mëshuar tri herë në shpinë me shkelëm. Pozita ime pas të qëlluarave që kam marrë, ka qenë i shtrirë në tokë në krahun e djathtë. Ne nuk kemi mundur me identifikua e kujt ka qenë vetura të cilët na e kanë thyer pasqyrën meqë e njehta veturë ka lëvizur shumë shpejt. Mendoj se goditja me automjetin e tyre ka qenë e qëllimshme, me qëllim që ne të ndalemi. Unë atë ditë nuk e kam parë atë veturë përveç se në momentin kritik. Nuk kam spejgim për mundësinë që ne nuk kemi mundur me e vërejtë veturën ndërsa ata neve po. Raportet e tona të më hershme me B. nuk kanë qenë të mira, meqë dy vite më parë, para këtij rasti jemi rrahur mes veti. Nga konflikti fizik e gjer në momentin kritik ne jemi takuar disa herë me B. por nuk kemi pasur probleme. Raportet e B. sipas meje me L. kanë qenë më të acaruara. Unë nuk kam mundur me vrapua pas L. edhe pas B. . Vendi ku ka shtënë B. ka qenë larg nga vendi ku ka ndodhur rrahja 100 metra largë, mirëpo unë nuk kam mundur me i pa se si ka ndodhur rrahja në mes L., B., V., A. dhe M. . Gjendja shëndetësore e imja nuk është fort e mirë, kam dhimbje në këmbën e djathtë. Plagët kanë qenë tej shpuese. Personi të cilin unë nuk e njihesha – e i cili ka qenë me B. me veturë, më ka dërguar me veturën e B. në Qendrën spitalore në Gjilan. Mosmarrëveshja në mes meje dhe B. nuk ka qenë e asi lloji që unë ta ndiej veten të rrezikuar dhe të mëshihem nga ai. Nuk e di arsyen pse B. ka shtënë në drejtimin tim dy herë ndërsa në drejtim të L. një herë edhe pse me L. i ka pasur marëdhëniet më të acaruara.

Me B. kemi patur raporte të mëhershme normale, ndërsa me të pandehurin M. para dy viteve kemi patur mosmarrëveshje.

Në kohën kur ka ndodhur rasti unë kam qenë duke punuar te Seperacioni te “...” në fsh.D. . Unë aty kam punuar me një ndërrim. Unë atë ditë kam qenë duke shkuar me e ngarkuar një kamion te seperacioni ku unë punoj me L. në këtë vend. Pasi që është goditur pasqyra e veturës sonë nga vetura e B., ne kemi vazhduar rrugën largë edhe nja 30 metra. Sjelljet e mia dhe të L. kur jemi ndalur me veturë kanë qenë normale çka do të thotë kemi

qenë të qetë. Në vendin e ngjarjes në mes L. dhe B. nuk ka patur kurrfarë kacafytje, do me thënë aty edhe kur ka shtënë B. .

I dëmtuari **L. D.**, nga fsh.D., si gjatë fazës së hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se ditën kritike rreth orës ..., bashkë me të dëmtuarin K. D., me veturën e markës "...", pronë e agjës tim A., jemi nisur që të shkonim në seperacionin ku punonim, dhe kur kemi mbërri në afërsi të shitores "...", vinte një veturë me shpejtësi shumë të madhe nga K. në drejtim të Gjilanit, jemi përball kaluar me veturën e të akuzuarit të cilën e ngiste një person i pa njohur për mua, vetura ishte e modelit "...", dhe unë duke lëvizur rrugës sime me shpejtësi normale, ndërsa vetura e tyre ishte me shpejtësi shumë të shpejtë, dhe veturat tona janë ndeshur ashtu që veturës sime i është thyer pasqyra anësore, e kam ndaluar veturën dhe kam shikuar në pasqyrë se a është ndaluar vetura tjetër, e njëjta është kthyer në drejtimin tonë te parku i fshatit, e unë kam bërë kthimin në rrugë dhe kam lëvizur në drejtim të tyre. Ata janë ndaluar te shitorja "...", dhe unë jam ndaluar në afërsi të tyre, e qëllimi im ishte që të ndalemi dhe të merremi vesh me ta. Nga vetura e tyre ka dalur i akuzuari B. dhe personi i pa njohur, poashtu kemi dalur edhe unë dhe K. D., i akuzuari na ka bërtitur "për çka ma mëshove", unë iu kam përgjigjur me fjalët: "se unë kam qenë në rrugën time dhe i kam thënë se ti nuk ke qenë duke vozitur por personi i pa njohur". Unë kam kërkuar që të thërrasim policinë, por i njejt me zë të lartë ka filluar të na fyejë me fjalët "ta q ... dhe na tha se unë tash do ta thërras policinë", e ka vuar telefonin në vesh dhe përnjëherë e ka shti në gjep, dhe e ka nxjerrur revolen nga brezi dhe ka gjuajtur në drejtimin tim, por nuk e di se si kam shpëtuar nga plumbi, i njejt ka qenë në afërsi timen 2-3 metra, është kthyer dhe ka gjuajtur edhe dy herë në drejtim të të dëmtuarit K. D.. I dëmtuari K. ka rënë në tokë, e pasi që e kam parë K. në tokë, kam vrapuar në drejtim të parkut për të kërkuar ndihmë, ka vrapuar 100 metra prapa meje i akuzuari B. me revole në dorë, dhe kur kam arritur tek kafiteria "...", unë i kam treguar V. dhe Gj. se e kan plagosur K. dhe në këtë moment më kanë goditur M. M. dhe A. K.. Në ndërkohë ka arritur i akuzuari B., më ka goditur me kondak të revoles në kokë, e në ndërkohë kanë arritur V. dhe Gj. e të njëjtit kanë tentuar që të na ndajnë, e B. ka arritur që ta godet edhe V. në kokë me kondak të revoles, ndërsa Gj. dhe V. kanë tentuar që B. t'ia marrin revolen nga dora. Të akuzuarit A. dhe M. që të dy më kanë goditur me grushta në kokë. Ka deklaruar se i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarve.

I dëmtuari **V. D.**, nga fsh.D., si gjatë fazës së hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi: Ditën kritike më dt. ... 2011, aty rreth orës ..., kam qenë duke pirë kafe me kolegun tim Gj. P. në kafiterinë "...", dhe i kam dëgjuar tri të shtëna. Për disa minuta kam dëgjuar britmën e L. duke bërtitur "o ku ku", në moment kam kërcyer nga terasa në tokë, e cila ishte në lartësi prej 3-4 metra për t'i ndihmuar se çfarë me të vërtetë po ndodh. E kam dëgjuar L. kur më tha që K. – vëllaun tim e kanë plagosur, deri sa jam kthyer në drejtim të akuzuarit B. ky më ka goditur dy herë me kundak të armës dhe atë pjesën e përparme të kokës të anës së djathtë, me armën të cilën e kishte në dorën e djathtë. Herën e parë kur më ka goditur më ka humbur vetëdija dhe kam ra në tokë, për nja 30 sekonda, jam ngritur në këmbë dhe përsëri prap e kam marrë një goditje në pjesën e mbrapme të kokës nga ana e B. me kondak të

revoles. Edhe pas goditjes së dytë kam ra në tokë përsëri, kolegu që ka qenë me mua duke pirë kafe – Gj. dhe disa fshatarë ia kanë marrë revolen B., ndërsa unë kam ra në tokë dhe pas 1 minuti përsëri jam ngritur në këmbë dhe e kam parë veten të gjakosur nga këto dy goditje, dhe pas kësaj menjëherë shoku im Gj. me veturën e tij më ka dërguar në Emergjencë në Gjilan.

L. dhe K. e kanë ditur se unë jam në kafiterinë “...” meqë kur kanë kaluar aty pari të njëjtit me veturën e tyre janë ndalur për të na përshëndetur. Posa më tha L. se e kanë plagosur K., unë kërceva nga terasa, dhe e pashë se B. e sulmonte L. me kondak të revoles një herë në kokë. Në këtë kafiteri para ndodhjes së rastit e kam parë duke pirë kafe M. dhe A. të cilët ishin afër meje me tavolina në distancë prej 2-3 metra. Pasi që kam kërcyer unë nga terasa e kam parë se M. dhe A. ka zbritur shkallëve të kafiterisë dhe kanë ardhur në vendin e ngjarjes. M. e ka marrë një karrikë të kafiterisë dhe atë duke zbritur nga shkallët e kafiterisë, ka tentua që të më sulmon mua nga mbrapa me karrikë, mirëpo Gj. ia ka marrë së shpejti nga dora karrigen. Dhe A. me grusht më ka sulmuar një herë në kokë dhe 2 herë në gjoks. Ndërsa unë nga goditjet që i mora nuk kam patur fuqi që të njejtëve t’i kundërvihem. Momentalisht nuk më kujtohet se M. a e ka sulmuar me grushta L. por mbetem pranë deklaratës që e kam dhënë në prokurori. Unë në dorë ndonjë mjet nuk iu kam parë A. dhe M. . Lëndime dhe plagë kam pasur nga B. i cili më ka goditur me kondak të revoles ndërsa goditjet me grushta nga ana e A. dhe M. nuk kanë qenë lëndime të mëdha.

Ndjekjes penale ndaj të pandehurve i bashkangjitem ndërsa kërkesë pasurore juridike nuk ushtroj.

Dëshmitari **Gj. P.** në shqyrtimin gjyqësorë nuk pranoi të dëshmojë lidhur me rastin, i cili deklaroi se mbetet në tërësi pranë dëshmisë së dhënë në polici më dt. ... .2011, në prokurori më dt. 05.07.2011, dhe në shqyrtimin gjyqësorë në procesverbalin e gjykimit paraprak të dt.16.12.2011, duke shtuar se kanë kaluar më tepër se 4 vite dhe frikohem se mos po gaboj dhe ndoshta nuk do të mund të deklarohej ashtu siç ka ndodhur rasti, e që trupi gjykues me pëlqimin e palëve mori vendim, dhe të njëjtit iu lexua deklarata e tij e dhënë në prokurori, e që pas leximit të deklaratës, deklarohet se e mbështet në tërësi pa ndryshime dhe plotësime, i cili poashtu deklaroi se nuk pranoj edhe përgjigjen e pyetjeve nëse më parashtrohen nga ana e palëve prezentë, ngase nuk kam tjetër çka të deklaroj dhe nuk kam njohuri tjera lidhur me rastin, e që me leximin e deklaratës u vërtetua se më dt. ... .2011, rreth orës ..., minuta ka qenë në kafiterinë “...”, në fsh.D. së bashku me V. D. dhe i ka dëgjuar dy krisma për të cilat nuk ka patur njohuri se a janë të revoles apo të fishekzjarrëve. Meqë ishin të ulur në terasë të kafiterisë, pas pak kohe e kam parë një person i cili vraponte dhe kërkonte ndihmë, me të dëgjuar kam zbritur poshtë, jam takuar me të dëmtuarin L. dhe ndërkohë ka arritur edhe i akuzuari B.. L. është mësëhur pas meje ndërsa i pandehuri B. mbante revolen të drejtuar në drejtimin tim, meqë pas meje qëndronte L. . Të njëjtit i kam bërëtitur se ki kujdes se e ke armën në dorë dhe mund të na vrasësh të gjithëve e aty afër pranë meje ka qenë edhe M. K. . B. e kam parë kur e ka goditur V. me kondak të revoles në kokë. Edhe të akuzuarit A. dhe M. kanë qenë prezent mirëpo nuk e kanë vërejtur asnjë veprim të tyre sepse unë në atë moment kam qenë i

*koncentruar tek revolja e të akuzuarit B.. Unë me forcë dhe me teknikën time që e posedoj si ushtar i FSK-ës, kam arritur t'ia marr armën B. e që edhe M ndoshta më ka ndihmuar pasi që edhe ai ka qenë aty me mua.*

*Dëshmitari **M. K.** gjatë fazës së hetimeve dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë deklaroi se më dt. ... .2011, rreth orës ..., kam qenë duke qëndruar në parkun e fsh.M. me dy kolegë dhe me këtë rast i kam dëgjuar dy krisma. Nuk kam patur njohuri se çfarë krisma kanë qenë, meqë shpesh ndodhë që fëmijët të luajnë me fishekë - zjarre. Për një kohë shumë të shkurtër nga parku i fshatit i kam parë duke vrapuar rrugës dy persona të cilët në fillim nuk i kam njohur e që vishin në drejtim të parkut. Kur të njëjtit janë afruar te kafiteria "...", nga kafiteria kanë dalur V. dhe Gj. dhe janë takuar me të akuzuarin B. dhe të dëmtuarin L.. Unë kam mundur ta vërej që i dëmtuari L. ka qenë duke ikur, ndërsa nga mbrapa e ka ndjekur i akuzuari B.. L. është mëshetur prapa Gj. dhe V. ndërsa B. mbante revolen në dorë, të kthyer mbrapsht. Unë e kam parë kur i akuzuari B. e ka goditur të dëmtuarin V. me kondak të revoles në kokë, dhe i njejtë ka rënë në tokë. E kam vërejtur se B. ka qenë i shqetësuar dhe e ka humbu kontrollin. Gj. gjatë kësaj kohe ka tentua që nga i pandehuri B. ta merr armën, e për këtë i kam ndihmuar edhe unë dhe kemi arritur që t'ia nxjerrim revolen prej dorës. Unë të pandehurin A. nuk e kam vërejtur, ndërsa të pandehurin M. e kam parë por nuk kam parë ndonjë veprim të pazakontë të akuzuarit M..*

*I akuzuari **B. K.** gjatë fazës së hetimeve edhe shqyrtimit gjyqësor deklaroi se deri në ora ..., më dt. ... .2011, kam qenë te mjeshtri i makinës së veturës bashkë me mikun tim E. K.. Aty kemi qëndruar nga ... e deri në ora ..., pasi që e kemi rregulluar veturën kemi shkuar në autolarje e një fqiut tim F.. Ne e kemi lënë veturën dhe kemi shkuar me pi kafe në kafiterinë "...", aty kemi qëndruar rreth gjysmë ore, aty për aty na ka lindur një ide që të dalim në piknik meqë kishte qenë ditë e diele, prej kafiterisë së bashku me mikun tim E. shkuam në shtëpinë time ku i morëm disa gjëra ushqimore dhe e kam marrë revolen time, në të cilën revole kam patur ... fishekë, kemi shkuar në mal mbi fsh.D. – tek stadioni i fshatit, aty kam shtënë me revole në shenjë , e di se kam shtënë me revole ... herë. Vendi ku kam shtënë unë me armë në shenjë ka qenë afërsisht 15 m larg dhe nuk e di se sa herë e kam qëlluar shenjën. Me mikun tim kemi konsumuar edhe birra dhe atë nuk e si saktë sa kemi konsumuar. Në këtë vend së bashku me mikun tim kemi qëndruar deri sa është errësuar. Ma merr mendja se nga ky mal jemi nisur për në shtëni rreth orës ...- ..., unë me mikun tim jemi nisur me veturë në drejtim të Gj., vetura kishte qenë e mikut tim nga Sh.. Kur kemi mbërri në mes shitoreve V. dhe F., e kam dëgjuar një krismë në veturë ashtu që kam pa se vetura jonë është fërkuar me një veturë tjetër duke u thyer pasqyra e veturës sonë. Fërkimi i veturave është bërë gjatë përballë kalimit, pasi që e kam parë që është thyer pasqyra kam dëgjuar borinë e veturës tjetër që do të thotë kemi kuptuar se është bërë aksident. Pas dëgjimit të borisë kemi vazhduar edhe nja 20-25 m, ku gjatë kësaj kohe kjo bori nuk u ndalte që do të thotë se na ka sinjalizuar që ne të ndalemi. Kemi bërë kthim në rrugë gjegjësisht kthim në rrugë kanë bërë së pari personat në automjetin me të cilin jemi fërkuar, atëherë edhe miku im e ka kthyer veturën e tij dhe kemi shkuar tek vendi ku janë ndalë ata personat me veturën tjetër. Veturat janë pozicionuar dhe atë ne jemi*



ndalur në anën e djathtë të rrugës shikuar drejtimin e lëvizjes tonë por më afër asfaltit kurse ana e kundërt me automjet është ndalë në të njejtën anë por më fellë nga asfalti. Distanca në mes veturave ka qenë afër 7 metra. Aty kam parë se nga vetura kanë dalur L. me K., e që edhe unë kur i kam parë të njejtit kam zbritur nga vetura, të njejtit i kam vërejtur të nervozuar shumë, aty së pari L. mu drejtua mu me fjalët “ku i keni sytë, qysh çka na i bëtë pasqyrës, filloi të më fyej me fjalët familjen dhe robte mi”, për ballë meje kanë qenë edhe L. e edhe K., biseda kur ka filluar, ata nga unë kanë qenë në largësi prej 4 metrave, kurse unë iu kam përgjigjur me fjalët “mos e bëni aq të madhe sështë bërë nami”. Atëherë ka ndërhy K. dhe më është drejtuar me fjalët “qysh mos me bërë të madhe duke shtuar se ketë tu na mbytë dhe ka filluar të më fyejë duke më sharë familjen”, pas këtyre fjalëve unë iu thash se është policia dhe do ta zgjidhim këtë problem. Gjatë gjithë kësaj bisede jemi ofruar në distancë shumë të afër njëri me tjetrin edhe atë për afërsisht 1 m por ata janë afruar nga unë e jo unë në drejtimin e tyre. Pas këtyre fjalëve dhe atë kur i thash që thërrasim policinë dhe e zgjidh këtë problem, e që unë posa e kam nxjerrë telefonin nga gjepi për ta ftuar policinë K. më ka kapur për fyti dhe më ka thënë çfarë policie këtë punë ti e lanë ndryshe dhe më ka mëshuar së pari me grusht K. e më pas edhe L. me grushta, dhe atë në kokë dhe në pjesë tjera të trupit. Miku im ka dalur nga vetura mirëpo nuk ka ndërmarrë kurfarë veprimi, dhe nuk e kam parë se miku im të jetë afruar në vendin e ngjarjes. Unë jam munduar me duar që të njëjtit t'i zmbropsi dhe ta mbroj vetveten, gjatë kësaj kohe më është kujtuar se e kam revolen në çantën ku i mbaj dokumentet dhe atë të varur në qafë, dhe gjatë kohës duke u mbrojtur e kam krijuar një hapësirë dhe e kam nxjerrë revolen nga çanta, dhe instinktivisht e di se revolen e kam drejtuar në drejtim të këmbëve të K. i cili nuk ishte më larg nga unë 2- 2.5 m, dhe qëllimi im ka qenë që ti frikësoj në mënyrë që të largohen nga unë. Në atë moment me revole kam shkrepur 2 herë dhe atë pas atij dajaku që e kam përjetuar nga ana e të njëjtëve, kam përdorur edhe armën. Pas dy shkrepjeve e kam pa që K. ka ra në tokë ndërsa L. nuk e di se ku ka mbetur dhe atë pasi që e kam nxjerrë revolen nga çanta, më të njëjtin nuk e kam pa. Më tutje deklaroi se nuk e di se ku e ka goditur K., kurse logjika ime ka qenë e drejtuar që ta godas në këmbë. Pasi që e kam parë K. që ka ra në tokë jam shqetësuar shumë dhe e di se mu ka kujtuar që të largohem nga vendi i ngjarjes, dhe jam nisur në drejtim të shtëpisë time dhe atë vet ndërsa miku im E e ka marrë K. dhe e ka dërguar në spital, e për këtë kam kuptuar më vonë edhe atë në burg.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit, i akuzuari përgjigjet se nuk e di se kur ka ikur në drejtim të shtëpisë sime a e kam pasur revolen në dorë apo jo. Në momentin kur jam nisur me vrap në drejtim të shtëpisë sime në rrugë më kanë dalë L. dhe V. dhe të njejtit më kanë sulmuar me grushta dore nëpër pjesë të ndryshme të trupit. Kurse unë e kam mbrojtur vet veten. Në momentin e fërkimit të veturave gjatë përballë kalimit nuk e kam ditur se e kujt është vetura dhe kush është në veturë. Pasi që kemi dalur nga vetura e kam vërejtur se kush ka qenë në veturë. Fërkimi i veturave mendoj se ka qenë aksidentale e jo e qëllimshme. Para ndodhjes së këtij rasti kemi patur raporte të mira me L. dhe K. . Me të njëjtin kemi shkuar në shkollë së bashku, kemi pirë kafe bashkë. Gjegjesisht sa i përket raporteve në mes L. dhe K.

*mund të them se kemi pasur një gjelozi fminore, kemi pasur edhe grindje por gjithnji gjatë sportit mirëpo ato raporte i kemi relaksuar në mes veti.*

*Në vend të ngjarjes me revole kam shkrepur dy herë në drejtim të këmbëve të K. i cili nga unë nuk ka qenë më larg se 2-2.5 m dhe qëllimi im ka qenë që ta largoj nga vetja dhe me e zbrapsë sulmin e tij dhe kushëririt të tij L. . Unë K. dhe L. jetojmë në një fshat dhe jemi njohur më parë, por nuk e di se çfarë veture kanë pasur në pronësi. Në momentin kur kam shtënë me revole L. nuk e kam parë. Meqë ka pasur ndriçim në rrugë, kam pa mjaftueshëm se çfarë ka ndodhur në vendin e ngjarjes, dhe atë ka patur ndriçim publik dhe ndriçim nga shitoret. Revolen e kam poseduar 2 vite më herët para ndodhjes së rastit kritik. Raportet familjare me të dëmtuarit i kemi të mira, kemi quar njerëz për pajtim dhe familjarisht jemi pajtuar edhe pse ata kanë shprehë pakënaqësi edhe atë K. dhe L., ndërsa në vitin 2012 një herë më kanë sulmuar në rrugë K. dhe L., dhe nga viti 2012 kurfarë problemi nuk kemi patur me të dëmtuarit dhe familjen time.*

*Qëllimi im nuk ka qenë që të dëmtuarit ti privoj nga jeta, e po të kisha dashur që ti privoj të njëjtit nga jeta atëherë kisha dashur shumë lehtë ti privoj nga jeta meqë largësia në mes meje dhe të njëjtëve ka qenë afërsisht 2 metra, në të vërtetë me rastin e shkrepjes në vend të ngjarjes nuk e kam pa L..*

*Meqë kam qenë i frustrum në vendin e ngjarjes unë nuk e kam pa V. kur e kam goditur por kur kam kuptuar se atë e kam goditur kam qenë shumë i penduar, pas këtyre fjalëve edhe i dëmtuari V. , deklaroi se përmes njerëzve që mi ka dërguar jem në dieni se B. ka shpreh keqardhje.*

*Barna mjeksore përdori për çdo ditë edhe atë që nga viti 2009.*

*Gjendjen faktike për veprën penale nën dipozitivin nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit (lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të PKK-ës) gjykata e vërtetoi nga dëshmia e e të dëmtuarve – dëshmitarëve K., L. dhe V. D., nga dëshmia e dëshmitarëve Gj. P, M. K., nga mbrojtja e të akuzuarit, nga provat materiale, shikimi i fotodokumentacionit nga vendi i ngjarjes me nr. NJHR-062-11 e dt. 26.04.2011, skica dhe fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes, nga raporti mjekësor në emër të të dëmtuarit K. D., me numër të referencës 15/06 të dt.25,26.06.2011, superekspertizës të ekzaminimit psikiatrik për gjendjen shëndetësore të akuzuarit B. K. me nr.370/2 të dt.01.12.2015, e punuar nga ekipi i ekspertëve Dr.A. B., psikiatër, Dr. B. O., psikiatër, Dr. A. V., psikologe.*

*Sa i përket raporteve të tjera mjekësore dhe lëndimet që i kanë pësuar të dëmtuarit K., L. dhe V. Demiri, bashkangjitur shkresave të lëndës – kanë të bëjnë me veprën penale nën pikën III, të dispozitivit të aktgjykimit.*

*Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësorë heq dorë nga vepra penale nën pikën II të dispozitivit të aktakuzës (mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-ës, për shkak se kjo vepër*

penale është përfshirë në aktin e amnistisë, andaj edhe trupi gjykues në konform të nenit 363 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-ës, e refuzoi akuzën për këtë vepër penale.

Meqë prokurori i shtetit mbeti pranë kualifikimit të njëjtë të kësaj vepre penale si në dispozitivin nën III, (lëndim i lehtë trupor në bashkëveprim nga neni 153 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës), trupi gjykues gjeti se kemi të bëjmë me parashkrimin absolut të ndjekjes penale, meqë për këtë vepër penale afati i parashkrimit relativ është i paraparë 2 vite dhe dyfishi i kësaj paraqet parashkrimin absolut, meqë nga koha e kryerjes së veprës penale (...2011), kanë kaluar më tepër se ... vite, kohë kjo që shpie në parashkrimin absolut të ndjekjes penale, andaj edhe është pushuar procedura bazuar në nenin 91 pika 6 të KPPK-ës, meqë ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit ( ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga raporti i shikimit të vendit të ngjarjes me nr.NJHR 062-211 të dt. ....2011, është vërtetuar se ditën kritike në fsh.D. ka patur të shtëna me armë zjarri dhe në vendin e ngjarjes janë gjetur dy gëzhoja të kal... mm ... .

Nga raporti mjekësor në emër të dëmtuarit K. D. me nr.të referencës 15/06 të dt...2011, është konstatuar se i njëjti ka pësuar dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohëshme për shëndetin.

Sipas raportit – super ekspertizës të ekzaminimit psikiatrik për gjendjen shëndetësore të akuzuarit B. K. me nr.370/2 të dt.01.12.2015, e punuar nga ekipi i ekspertëve Dr. A. B., psikiatër, Dr.B. O., psikiatër, A. V., psikologe, është konstatuar se i njëjti është person me çrregullim mendor të quajtur çrregullim i personalitetit i pa specifikuar, që në klasifikimin ndërkombëtarë të sëmundjeve mendore kodohet si F60.9, sipas ICD -10 i cili çrregullim karakterizohet me : tensionim nervor, prag i ulur në situata frustrative, indiferencë emocionale, të menduar rigjid, pa ngjyrim, reagime të vrullshme edhe në ngacmues më të dobët, probleme me përshtatjen, probleme në raportet ndër njerëzorë, me rrethin social, pa aftësi për lidhje emocionale të qëndrueshme e që aftësia e tij mendore e të kuptuarit dhe kontrollës së veprimeve të veta në momentin e kryerjes së veprës për të cilën ngarkohet ka qenë e zvogëluar, jo esencialisht.

Andaj gjykata nuk ka gjetur asnjë bazë për përjashtimin apo zvogëlimin e përgjegjësisë së tij dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të përshkruar si në dispozitivin nën I. të aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit B. K.t, i cili edhe ka pranuar se për shkak të aksidentit të atë qasshëm (thyerjen e pasqyrës anësore të veturës), pas disa fyerjeve dhe mosmarrëveshjeve verbale që kishin patur, duke u përpjekur që njëri tjetrit t'ia lënë fajin e aksidentit, e me qëllim që t'i frikësoj të dëmtuarit, ka shtënë një herë me armë në drejtim të këmbëve të dëmtuarit L. dhe dy herë me armë në drejtim të këmbëve të dëmtuarit K., të cilës mbrojtje trupi gjykues edhe ia fali besimin.

*Pas këtij aksidenti të atë qasshëm kur i dëmtuari L. është ndalur me veturë për ta kuptuar shkakun e aksidentit ka patur fyerje dhe mosmarrëveshje verbale në mes të akuzuarit B. dhe të dëmtuarve K. dhe L., e që i akuzuari B. e ka marrë në dorë telefonin kinse po e thërret policinë, është larguar afër 3 metra larg tyre, ka nxjerrë revolen nga brezi dhe së pari një herë ka shtënë në drejtim të këmbëve të L., e që nuk është goditur e më pas dy herë ka shtënë në drejtim të dëmtuarit K. të cilin e godet me nga një predhë në të dy këmbët mbi gjunjë, të cilit edhe i shkakton lëndim të lehtë truporë, ashtu që në të njëjtën kohë gjykata konsideron se ka rrezikuar edhe jetën e të dëmtuarit L., i cili ishte në pozitë paralele, në distancë afër 1 metër - në krahun e djathtë të të dëmtuarit K., në momentin kur i akuzuari B. në distancë prej afro 3 metra ka shtënë në drejtim të tyre.*

*Njëherit trupi gjykues konsideron se ditën kritike i akuzuari B. armën e kishte me vehte dhe që e kishte përdorur në piknik - në mal në fsh.D., dhe se nuk ka qenë i përgatitur, rastësisht i kishte qëlluar arma me vehte, dhe se i njëjti nuk e ka ditur se ditën kritike do të takohej me të dëmtuarit dhe do t'i ndodhte aksidenti e me qëllim që ti frikësoj të dëmtuarit - për shkak të mosmarrëveshjeve dhe fyerjeve që kanë patur rreth aksidentit ka përdorur edhe armën ndaj të dëmtuarve.*

*Dashja e të akuzuarit B. nuk ka qenë e orientuar në privimin nga jeta e të dëmtuarve, sepse duke patur parasysh distancën e gjuajtjes 3-4 metra ka mundur ta godas në kokë apo në pjesë vitale të trupit, e meqë mungon dashja si element subjektiv i kësaj veprë penale në rastin konkret gjykata konsideron se në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale të lëndimit të lehtë truporë nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPK-ës, ku në paragrafin 2 taksativisht përcaktohet se kjo veprë penale përkatësisht ky lëndim i lehtë trupor shkaktohet me armë siç është rasti konkret. Në kontekst të shkaktimit të veprës penale lëndim i lehtë truporë flet edhe mendimi përkatësisht konstatimi i ekspertit mjeko - ligjorë me numër të referencës 15/2006 të dt... .2011, ku thekson se në këtë rast kemi të bëjmë me plagë me armë zjarri në regjionin femoral në të dy anët që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme për shëndetin nga i cili konstatim vërtetohet se të dëmtuarit K. D. i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin e të cilat lëndime nuk kanë qenë të rrezikshme për të dëmtuarin. Meqë kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme për jetën e të dëmtuarit, dhe pasi që nuk ka pasur lëndime të cilat e kishin rrezikuar jetën e të dëmtuarit konsiderojmë se ka arsye të bazuara për mosekzistimin e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës.*

*Me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 64 të KPK-ës, të cilat janë me ndikim në caktimin e lartësisë dhe llojit të dënimit për të akuzuarit.*

*Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin B. K. ka mare parasysh faktin gjegjësisht sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësorë, më parë i pa gjykuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë edhe për veprë tjetër penale, moshën e tij relativisht të re, i cili në kohën*

*e kryerjes së veprës penale, ka patur vetëm ... vjet, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale, pendimin e tij, gjatë gjithë procedurës iu ka kërkuar falje publike të dëmtuarve, ka shpreh keqardhje, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ia ka vlerësuar intensitetin e lartë të rrezikimit të vlerave të mbrojtura siç është jeta e njeriut, faktin se i dëmtuari iu ka bashkangjitur ndjekjes penale, andaj edhe kjo gjykatë ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe në këtë mënyrë do të ndikohet në arritjen e qëllimit të ndikimit si masë për rehabilitimin dhe risocializimin, por edhe si masë për parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale.*

*Ndaj të akuzuarit B. K. i është shqiptuar dënimi plotësues – konfiskimi i armës së zjarhtë – revole të markës “...” kal... mm, me nr. serik ...*

*Kërkesë pasurore juridike nuk pati.*

*Shpenzimet e procedurës penale sa i përket veprës penale nën pikën II dhe III të aktgjykimit bien në barrë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në dispozitën e nenit 450 dhe 454 të KPPK-ës.*

*I akuzuari B. K. obligohet që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €.*

*Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE**  
**Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan**  
**Më dt. 06.05.2016.**

**Sekretare juridike,**  
*Fatmire Sermaxhaj,d.v.*

**Kryetarja e trupit –gjyqtarja,**  
*Emine Salihu,d.v.*

**KËSHILLA JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa ushtrohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.*